

Ajet kuranor

Allahu i Madhërishëm thotë:

? ????????? ????????? ????????????? ????????????? ?????????? ??? ????????????? ?????????
???????? ????????????? ????????????????? ????????????????? ?

"Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim (rizk): jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut." (Kurani, 20:132)

Thënie profetike

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ?, ka thënë:

"Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namazin kur t'i mbushin shtatë vjet..."

[E shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ahmedi.]

Urtësi

Kurtubiu, lidhur me ajetin e mësipërm, ka thënë:

"Pjesa Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim (rizk) domethënë: Ne nuk kërkojmë nga ti që ta furnizosh as veten, as familjen tënde, e ta lësh namazin për shkak të kërimit të ushqimit, ngaqë Ne (Allahu) e kemi marrë përsipër furnizimin tënd dhe të atyre."

Më duhet ta mbaj familjen, ndaj s'mund të falem (!)

Allahu është Ai që të furnizon ty dhe familjen tënde. Madje, çdo dhunti që kemi, është nga Allahu, andaj duhet ta falënderojmë për këtë. Pos kësaj, namazi është një prej shkaqeve të shtimit të furnizimit, prandaj, si ka mundësi ta pakojë atë?!

Këshillë

Urdhëroje familjen tënde që të falen! Nëse të kundërshtojnë, kurrësi mos u dëshpëro e mos u spraps, por vazhdo t'i thërrasësh në namaz me urtësi dhe gjithnjë lute Allahun t'i udhëzojë ata.

Përgatiti: Hoxhë Jusuf Kastrati